



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2024:067932

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05758690

P.nr.62/2024

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me procesmbajtësen Vjollca Bytyqi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit N.B., nga fsh. Semetisht komuna Suharekë, i akuzuar sipas aktakuzës PP/II nr.153-20/24 të datës 28.02.2024 për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të Kodit Penal, në prezencë të prokurorit të shtetit Shahadin Destani të akuzuarit N.B., dhe të dëmtuarit E.B., në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me dt. 29.05.2024 mori, publikisht shpalli dhe me datë 30.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, N.B., nga i ati e nënae lindur, i lindur mënë fsh. Semetisht komuna Suharekë, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, i dënuar edhe më parë.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 20.12.2023 rreth orës 12:00 në fshatin Semetisht, Komuna Suharekë, i pandehuri shkaktonte lëndim të lehtë trupor që rezultoi me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të dëmtuarit E.B.; në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke lëvizur me veturën e tij, i pandehuri i bën me dorë që të ndalet dhe në momentin që i dëmtuari e ndalon veturën dhe e hap dritaren, i pandehuri afrohet dhe e kap të dëmtuarin nga fyti duke i thënë “pse ti po vozit shpejtë dhe po bën zhurmë” si dhe fjalë të tjera dhe më pas e liron, me të cilin veprim tek i dëmtuari shkaktonte ndrydhje në indet e buta të qafës, të konstatuara në akt ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. Ditor Haliti të dt. 22.02.2024.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 38, 40 par. 1 pika 1.3, 43, dhe 69 KPRK-së, si dhe 364 dhe 460 të KPPRK-së, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në lartësi prej 300 (treqind) €, e cila gjobë duhet të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari dënimin në të holla nuk e paguan në afatin e paraparë, gjykata dënimin me gjobë do të i' a zëvendësoi në dënim me burgim prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgimi me 20 euro.

Obligohet i akuzuari që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyruar.

I dëmtuari E.B., fsh. Semetisht komuna Suharekë, udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike, ta realizoj në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH-e, me aktakuzë PP/II nr.153-20/24 të datës 28.02.2024, ndaj të akuzuarit N.B., nga fsh. Semetisht komuna Suharekë, i akuzuar për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të Kodit Penal, të cilin gjatë seancës së shqyrtimit fillestar e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Shahadin Destani, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë, që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e të akuzuarit e ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 251 të KPPRK-së, në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit, është bërë vullnetarisht në shqyrtimin fillestar, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuzën, të cilat gjinden në shkresat e lëndës si dhe provat materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH-së, në Prizren.

Gjykata po ashtu në tërësi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar nga ana e të akuzuarit, është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 242 të KPPRK-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte të cilat i përmban aktakuzën, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të Kodit Penal, gjykata vendosi se i akuzuari është fajtor për veprën penale si në aktakuzë, andaj i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke gjetur si rrethanë rënduese, se edhe më parë ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi, pranimin e fajësisë, dhe zotimin se në të ardhmen nuk do të përsërit vepra të tilla apo të ngjashme, andaj gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla apo të ngjashme.

Gjykata vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil, e mori konform nenit 462 par. 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u murrë në kuptim të nenit 450 dhe 452 të KPPRK-së.

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëj kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 449 par. 2 pika 2.9 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË

G j y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.